

LIGJI 06/L-043 PËR LIRI TË ASOCIIMIT NË OJQ - PËRMBLEDHJE

FAKTE

- I hartuar gjatë viteve 2016-2017, me përfshirje të gjerë institucionale dhe të shoqërisë civile dhe me ekspertizë vendore e ndërkombëtare;
- I bazuar në Udhëzuesin e Komisionit të Venedikut për liri të asociimit të vitit 2014;
- I bazuar në analiza të thella të praktikës së zbatimit të ligjit aktual në Kosovë;
- I ndërtuar mbi koncenzusin ndërsektoral të zhvilluar nëpërmjet diskutimeve të shumta;
- I miratuar nga Qeveria e Kosovës në dhjetor 2017;
- I miratuar në lexim të parë nga Kuvendi në mars 2018;
- I diskutuar në dëgjim publik nga Komisioni për Media dhe Administratë Publike në prill 2018;
- I miratuar në lexim të dytë më 7 nëntor, me 36 amendamente
- I kthyer nga Presidenti, pas kërkesës nga KCSF dhe 76 OJQ tjera, më 23 nëntor 2018

PROBLEMET KRYESORE

NË PËRMBAJTJE

- **Është rrezikuar parimi jo për përfitim nëpërmjet ndryshimit të bazës së shpërndarjes së pasurisë së OJQ-ve pas shuarjes, duke mundësuar shpërndarjen e pasurisë së OJQ-së jashtë sektorit jo-qeveritar, përfshirë në sektorin privat (Neni 41, Amandamenti 31)**
 - o “Institucionet” (si publike ashtu edhe private) janë shtuar si pranues të mundshëm të pasurisë së OJQ-së së shuar;
 - o Dispozita e re është në kundërshtim me parimin jo për përfitim të OJQ-ve, duke mundësuar shpërndarjen e pasurisë së OJQ-së jashtë sektorit jo-qeveritar, përfshirë në sektorin privat;
 - o Dispozita e re është në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO 97/12 për Ligjin për Bankat, lidhur me nismën për lejimin e transformimit të OJQ-ve mikrofinanciare.
- **Është ndryshuar baza e shuarjes së OJQ-së nga jo-solvente në jo-aktive (Neni 41, Amandamenti 30)**
 - o Jo-solvenca është pa-afhtësia për të paguar, definohet në Ligjin për falimentim dhe ka karakter financiar;
 - o Jo-aktiviteti është koncept jo-financiar, nuk definohet as në legjislacionin kosovar e as në praktikën ndërkombëtare;
 - o Interpretimi i jo-aktivitetit si bazë për shuarje krijon mundësi të drejtpërdrejtë për vendime arbitrare në raport me shuarjen e OJQ-ve dhe rrezikon të drejtën kushtetuese të lirisë së asociimit;
 - o Parimet ndërkombëtare e përcaktojnë “vendimin e gjykatës” si bazën e vetme të jashtme për shuarjen e një organizate.
- **Rritet numri minimal i personave për të themeluar shoqata, nga 3 në 7 (Neni 16, Amandamenti 5)**
 - o Kosova shënon hapa mbrapa, nga viti 1999 janë kërkuar vetëm 3 themelues;
 - o Parimet ndërkombëtare kërkojnë vetëm 2 themelues;
 - o Vetëm dy vende europiane (Gjermania me Kodin Civil të vitit 1896¹ dhe Turqia) kërkojnë nga 7 themelues;
 - o Nuk ka pasur asnjë problem të raportuar me 3 themelues nga viti 1999.
- **Rritet numri minimal i personave për të themeluar fondacione dhe institute, nga 1 në 3 (Neni 17, Amandamenti 6 & Neni 18, Amandamenti 7)**
 - o Fondacioni është organizatë pa anëtarësi, i bazuar në kapital (pronë ose pasuri), dhe nuk ka asnjë ndërlidhje me numër të themeluesëve/anëtarëve;
 - o Instituti është organizatë pa anëtarësi, i bazuar në dije dhe ekspertizë, dhe nuk ka asnjë ndërlidhje me numër të themeluesëve/anëtarëve;
 - o Nuk ka asnjë praktikë të ngjashme të themelimit të fondacioneve dhe instituteve me më shumë se 1 themelues;
 - o Deformohet koncepti i fondacioneve dhe instituteve duke e ndërlidhur me numër të themeluesëve.
- **Është shtuar kërkesa e vërtetimit të aktit themelues te noteri (Neni 15, Amandamenti 8)**
 - o Parimet ndërkombëtare kërkojnë që procedurat e regjistrimit të jenë të thjeshta, jo të vështira, të shpejta dhe pa pagesë, si dhe më të ngarkuara, burokratike dhe më të gjatë sesa për biznese;

¹ <http://www.koeblergerhard.de/Fontes/BGBDR18961900.htm>, Neni 56

- Praktika e regjistrimit dëshmon që akti themelues kthehet disa herë nga Departamenti për OJQ, për çështje teknike, rrjedhimisht duhet të noterizohet disa herë;
- Kosova shënon hapa mbrapa, nga viti 1999 themelimi e regjistrimi janë pa pa pagesë, së fundmi edhe online;
- Nuk ka pasur asnjë problem të raportuar me aktet themeluese nga viti 1999.
- **Janë larguar “zhvillimi ekonomik” dhe “zhdukja e varfërisë” si aktivitete me interes publik (Neni 37, Amandamenti 17 & Amandamenti 18 & Amandamenti 23)**
 - Zhvillimi ekonomik dhe zhdukja e varfërisë janë prioritete kombëtare të Kosovës;
 - Ligji për OJQ është dokumenti i vetëm që i definon në mënyrë ligjore aktivitetet me interes publik për organizata të shoqërisë civile;
 - Largimi i këtyre dy aktiviteteve nga kjo listë hap rrugë që OJQ-të mikrofinanciare të mos obligohen t'i raportojnë Departamentit për OJQ për punën e tyre në interes publik;
 - Nga rreth 250 OJQ me Status për Përfitim Publik, rreth 1/3 e tyre hyjnë në këto dy kategori.
- **Është larguar mundësia e lehtësirave tatimore e fiskale për OJQ-të me Status për Përfitim Publik (Neni 37, Amandamenti 21)**
 - Nga viti 1999, Kosova ka Statusin për Përfitim Publik, i cili bazohet në lehtësirat tatimore e fiskale për organizatat që angazhohen në mënyrë parësore në avancimin e interesit publik;
 - Pa mundësinë e lehtësirave tatimore e fiskale, Statusi për Përfitim Publik mbetet vetëm me obligime shtesë, rrjedhimisht i pakuptimtë
- **Është larguar mundësia e aplikimit për Status për Përfitim Publik (SPP) pas momentit të regjistrimit (Neni 37, Amandamenti 19)**
 - OJQ-të janë të lira që të vendosin vet për çështjet e brendshme, përfshirë fushën e veprimtarisë, përgjatë gjithë jetëgjatësisë së organizatës;
 - Vendimi për aplikim për SPP lidhet me raportin në mes të obligimeve shtesë për raportim dhe lehtësirave nga ky status, e të cilat ndryshojnë përgjatë kohës;
 - SPP lidhet me aktivitetin parësor të organizatës, i cili gjithashtu mund të ndryshojë edhe pas momentit të regjistrimit;
 - Kosova tashmë ka shumë organizata që po i afrohen 20 vjet të ekzistencës, dhe asnjëra prej tyre nuk ka pasur mundësi që në momentin e regjistrimit të parashohë në detaje zhvillimin e organizatës dhe kontekstit të jashtëm gjatë kësaj periudhe, për të vendosur për SPP;
 - Nuk ka pasur asnjë problem të raportuar me aplikimin për SPP pas regjistrimit nga viti 1999.
- **Është larguar mundësia e shndërrimit të shoqatave dhe fondacioneve ekzistuese në formën e re të institutit, gjatë një periudhe kalimtare (Neni 47, Amandamenti 37)**
 - Instituti është formë e re e përfshirë në ligj, si reflektim i praktikave moderne ndërkombëtare dhe nevojave të brendshme në Kosovë;
 - Shoqatat dhe fondacionet ekzistuese, të cilat realisht veprojnë si institute, duhet t'u mundësohet kalimi në këtë formë, për të reflektuar formën e tyre të vërtetë të organizimit.

NË PROCES

- **Rrezikohet parimi kryesor, ai jo për përfitim, duke krijuar pasiguri juridike për të gjitha OJQ_të dhe donatorët e tyre**
 - Mundësimi i transferimit të aseteve të OJQ-ve në sektorë të tjerë (përfshirë institucionet private) do t'i parandalojë donatorët nga garancionet e domosdoshme ligjore që donacionet e tyre do të përdoren për qëllimet jo për përfitim;
- **Nuk është marrë parasysh koncenzusi ndërsektoral i ndërtuar përgjatë 2 viteve**
 - Verzioni i miratuar nga Qeveria dhe në lexim të parë ka qenë koncensual dhe ka gjetur baraspeshën e trajtimit të brengave të të gjitha palëve me interes;
- **Nuk janë marrë parasysh argumentet e ofruara nga shoqëria civile gjatë shqyrtimit në Kuvend**
 - Njëpërmjet pjesëmarrjes në dëgjim publik dhe kontributeve me shkrim, shoqëria civile ka ofruar argumente të detajuara kundër ndryshimeve të dispozitave përkatëse;
- **Është prishur integriteti i ligjit;**
 - Ndryshimi i disa dispozitave pa reflektuar përgjatë dispozitave të ndërlidhura e bën Ligjin të pazbatueshëm;
- **Është kundër qëndrimeve zyrtare dhe politikave të miratuara të Republikës së Kosovës**
 - Kufizimet në ushtrimin e lirisë së asociimit janë në kundërshtim me parimet ndërkombëtare të zbatueshme edhe në Kosovë, Kushtetutës së Kosovës dhe politikave publike të Kosovës.

KËRKESA E SHOQËRISË CIVILE

Aprovimi në lexim të tretë sipas kërkesave të shoqërisë civile, respektivisht amandamenteve të propozuara nga Presidenti